



Newsletter Bota e SIGAL UNIQA

Botimi për muajin gusht 2024

Ju eksploroni, ne ju mbrojmë

Sigurimi ditor Kasko dhe AutoSOS
për të gjitha automjetet në Rentout

 **Rentout**

Shkarkoni Aplikacionin

GET IT ON
Google Play

Available on the
App Store

PËRMBAJTJA

Sigurimi për Sportistët/ SIGAL UNIQA partneri besnik i FSHF. Ndërtoni një karrierë të suksesshme

“Nuk ka surpriza”, Top News: SIGAL UNIQA, lidere e sigurimeve edhe për 6-mujorin e parë 2024

Sigurimet/ SIGAL UNIQA, fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi në të gjithë Shqipërinë

3.63 milionë shqiptarë, pushime jashtë vendit në 6 muaj/ 80% zgjodhën “Shëndet në Udhëtim” nga SIGAL UNIQA

Besim konstant dhe i konsoliduar/ SIGAL UNIQA mbetet zgjedhja e parë për Sigurimin e Jetës, Shëndetit, Pronës dhe Automjetit

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve arrin në mbi 41 mijë/ “SIGAL UNIQA Invest”, më i madhi në vend sa i përket aseteve

KOSOVA

Raporti i BQK/ SIGAL UNIQA, lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

MAEDONI E VERIUT

Sigurimet e Jo-Jetës në Maqedoninë e Veriut arrijnë një rekord të ri/ Mbi 21 milionë euro prime vetëm në korrik

UNIQA

‘Dëmet e shkaktuara nga moti ekstrem po rriten’/ Çfarë propozon CEO i “UNIQA Insurance Group”

Ndërto rrjetin. Sill ndryshim. Bashkohu me komunitetet

Jetojmë më mirë së bashku

SIGAL UNIQA Group Austria është sot një kompani me standarte tërësisht europiane, e cila i shërben me përkushtim klientëve, qytetarëve, komunitetit, u shërben atyre me të cilët ne shkëmbehemi në rrugë, atyre që sapo dalim nga shtëpia dhe u themi mirëmëngjes, atyre me të cilët ndajmë jetën në qytet, atyre me të cilët ndajmë vlerat dhe jetën tonë të përditshme.

Çdo ditë SIGAL UNIQA punon, rritet, ecën përpara, zgjeron partnerët, stafi n me qëllimin e vetëm: ofrimin e një shërbimi sa më profesional ndaj klientëve që jetën, shëndetin, pronën, automjetin dhe pensionin privat ia besojnë pikërisht kësaj kompanie. Sepse çdo klient i SIGAL UNIQA, i vogël apo i madh, është pjesë e një familjeje të madhe që sot numëron mbi 1 milion anëtarë.

jetojmë më mirë së bashku

Sigurimi KASKO me SIGAL UNIQA

Merr një
Ofertë





rritemi më mirë së bashku

Ngjarjet kryesore

SIGAL UNIQA partneri besnik i FSHF. Ndërtoni një karrierë të suksesshme



Federata Shqiptare e Futbollit dhe SIGAL UNIQA Group Austria zhvilluan një takim informues në “Shtëpinë e Futbollit” me përfaqësues të klubeve të Kategorisë Superiore në prag të fillimit të sezonit të ri futbollistik 2024/2025, që do të ngrejë siparin të dielën më 18 gusht.

Fokusi i diskutimeve ishte përditësimi i politikave të sigurimit të lojtarëve të Kategorisë Superiore dhe protokollet që ndiqen në rastet e dëmtimeve të lojtarëve.

SIGAL UNIQA Group Austria prezantoi disa paketa të sigurimit për klubet, që përfshijnë lojtarët e akademive, të cilët mund të aktivizohen edhe me ekipin e parë dhe mund të përfitojnë nga rimbursimi në rast dëmtimi. Federata Shqiptare e Futbollit dhe SIGAL UNIQA Group Austria kanë një bashkëpunim të suksesshëm që prej vitit 2016-të. SIGAL UNIQA Group Austria është një ndër sponsorët kryesorë të FSHF-së dhe Kombëtares së futbollit teksa kontributi dhe mbështetja gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë e madhe.

Por çfarë mbulon “SIGURIMI I SPORTISTËVE” nga SIGAL UNIQA?

Si sportistë profesionistë, por edhe nëse jeni sportistë amator, ju do të keni nevojë për sigurimin nga dëmtimet apo aksidentet që mund të ndodhin.

PAKETA E “SIGURIMIT PËR SPORTISTËT” NGA SIGAL UNIQA OFRON MBULIM PËR:

- Humbje jete në rast aksidenti sportiv
- Paaftësi e përkohshme në rast aksidenti sportiv
- Paaftësi e përkohshme (Shpërblim ditor)
- Shpenzime mjekësore në rast aksidenti sportiv

Përfitimet:

- Garanci financiare për sportistin për shpenzime mjekësore nga aksidenti
- Vlerë për punëdhënësin që siguron sportistët
- Garanci për ekipin që detyrimet që mund ti lindin i paguan siguruasi

Kujt mund ti ofrohet?

Të gjitha Federatave
Të gjitha ekipeve sportive
Sportistëve në sporte individuale

Sa kushton?

Dhe nuk kanë qenë të paktë sportistët që kanë përfituar nga ky sigurim.

Një prej tyre është edhe basketbollistja e Flamurtarit, Serena Brahimaj.

“Për këdo që merret me sport rreziku për dëmtime është shumë i lartë. Ndaj sigurimi është shumë i rëndësishëm. Këtë e vërteton edhe eksperiencia ime personale.

Pas një dëmtimi që pësova në këmbë mu desh ti drejtohesha një prej spitaleve private në vend dhe fatmirësisht gjithçka shkoi mirë dhe sot jam sërish në fushën e lojës”.

SIGAL UNIQA, gjithmonë në mbështetje të Sportit

Sporti ka një rëndësi të veçantë për një shoqëri. Jo vetëm në aspektin fizik dhe mendor por edhe përfaqësimit në kompeticione ndërkombëtare si ambasadorja më e mirë e vendit.

Për këtë SIGAL UNIQA Group Austria ka qenë dhe vazhdon të jetë përkrah sportit si sponsor zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit dhe klubit më të famshëm të basketbollit në Kosovë, SIGAL Prishtina. Por pa anashkaluar edhe investime të tjera.

Nuk duhet të ndaleni. Nëse hasni në një pengesë, SIGAL UNIQA Group Austria është pranë jush në çastet tuaja më të vështira. Për këtë arsye, ju ftojmë të blini Sigurimi nga Aksidentet për Sportistët në mënyrë që karriera juaj të mos mbetet në duart e fatit.

SIGAL UNIQA Group Austria, Jetojmë më mirë së bashku...

Federatat, Klubet Sportive dhe Sportistët në Grupe apo individë mund të kontaktojnë për të marrë një ofertë në:


Web: Sigal.com.al

E-mail: info@uniqa.al

WhatsApp: +355 68 606 2829



“Nuk ka surpriza”, Top News: SIGAL UNIQA, lidere e sigurimeve edhe për 6-mujorin e parë 2024



Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) publikoi fundjavën e shkruar raportin mbi ecurinë e tregut të sigurimeve për 6 mujorin e parë të vitit 2024.

Sipas raportit, primet e shkruara bruto u rritën me 7.55% krahasuar me periudhën janar – qershor 2023.

Ndërkohë, numri i kontratave të sigurimit tarriti në 699,453 me një rritje prej 9.62% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Por cila është kompania që kryeson tregun e sigurimeve në Shqipëri?

Si në Sigurimet e Jo-Jetës ashtu edhe në ato të Jetës, SIGAL UNIQA dhe SIGAL LIFE UNIQA vazhdojnë të jenë lidere në treg, si sa i përket primeve të shkruara ashtu edhe dëmeve të paguara...

Në Sigurimet e Jo-Jetës, klasa që dominon tregun me 91 %, kompania shqiptaro-austriake zë 28% të tij, ndërsa është para edhe në dëmet e paguara me 23.5% të totalit nga 8 kompani gjithësej.

E njëjta gjë edhe në Sigurimet e Jetës, ku SIGAL LIFE UNIQA mbetet preferenca numër 1 e qytetarëve dhe bizneseve teksa është në krye sa i përket dëmeve të paguara.

PSE SIGAL UNIQA VIJON TË JETË KOMPANIA MË E BESUAR E SIGURIMEVE? Kompania ka mbi 25 vite që operon në tregun e sigurimeve dhe ka ditur gjithmonë të jtë një hap përpara të tjerëve. Si në risi, inovacion, shërbimin profesional të klientëve dhe pagimin në kohë të dëmeve.

Pa harruar faktin që SIGAL është pjesë e një grupi të madh sigurimesh siç është “UNIQA INSURANCE Group“, çka ofron më shumë garanci dhe siguri për klientët.

SIGAL UNIQA Group Austria, Jetojmë më mirë së bashku

Web: www.sigal.com.al

E-mail: info@uniqa.al

Whatsapp: 068 606 2829

Sigurimet/ SIGAL UNIQA, fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi në të gjithë Shqipërinë



Sigurimet janë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë. Por për shkak të rrethanave të ndryshme, në Shqipëri nuk është ende në nivelet e duhura.

Tregu i sigurimeve në vendin tonë mbetet ende shumë i vogël dhe i pazhvilluar, edhe pse afro gjysma e tij zotërohet nga kompani të mirënjohura që operojnë në të gjitha tregjet europiane.

Dhe një rol të rëndësishëm këtu luan edhe edukimi financiar, i cili mungon në kurrikulat e shkollave tona.

Për të dhënë një informacion të përgjithshëm mbi sigurimet, çfarë ofrojnë ato dhe pse janë kaq shumë të rëndësishme, SIGAL UNIQA Group Austria ka nisur një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi në disa prej qyteteve të vendit.

Kjo fushatë ka filluar tashmë në qytetin e Pogradecit, Fierit, Shëngjinit, Gjirokastrës,

Durrësit, Beratit, Shkodrës, Velipojës dhe Kavajës ndërsa së shpejti do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë

“SIGAL UNIQA Group Austria ka nisur fushatën e saj të informimit të qytetarëve në të gjithë vendin!

Kjo fushatë ka filluar tashmë në qytetin e Pogradecit, Fierit, Shëngjinit, Gjirokastrës, Durrësit, Beratit, Shkodrës, Velipojës dhe Kavajës, dhe do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Ne jemi të përkushtuar për të ofruar informacion të qartë dhe të dobishëm për të gjithë qytetarët tanë.

Qëndroni të informuar dhe bashkohuni me ne në këtë nismë për të përmirësuar komunikimin dhe shërbimet për komunitetin tonë!


SIGAL UNIQA Group Austria, jetojmë më mirë së bashku!“, shkruan kompania në profilet e saj në rrjetet sociale.

3.63 milionë shqiptarë, pushime jashtë vendit në 6 muaj/ 80% zgjedhën “Shëndet në Udhëtim” nga SIGAL UNIQA



Tregu i Sigurimeve të Shëndetit në Udhëtim

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare/ Raporti janar - qershor 2024



Numri i shqiptarëve që kanë zgjedhur të kalojnë pushimet jashtë vendit ka arritur nivele të larta.

Sipas INSTAT janë regjistruar rreth 3.63 milion dalje nga pikat kufitare në territorin e Shqipërisë, 600 mijë më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku shumica kanë fluturuar të paktën më shumë se një herë.

Shtrenjtimi i produkteve dhe shërbimeve në vend ka çuar shqiptarët të kërkojnë destinacione të cilat përmbajnë oferta turistike më të mira e favorizuar kjo dhe nga zhvlerësimi i monedhës Euro e cila po tregtohet në nivele shumë të ulta kundrejt valutës vendase.

Nga ana tjetër të dhënat e fundit nga Banka e Shqipërisë që i referohen 3-mujorit të parë të vitit, tregojnë se shqiptarët kanë shpenzuar për pushime jashtë vendit një total prej 541.3 milionë

eurosh.

Kjo është një rritje prej 86.75 milionë euro nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar, duke theksuar një tendencë të rritur për shpenzime gjatë udhëtimeve ndërkombëtare.

Destinacionet kryesore për shqiptarët mbeten Italia, Turqia dhe Greqia.

Por që të udhëtosh jashtë Shqipërisë duhet edhe Sigurimi “Shëndet në Udhëtim”, i cili na mbron nga:

- Shpenzimet për emergjenca mjekësore në rast sëmundje apo aksidenti jashtë Shqipërisë
- Evakuim mjekësor dhe riatdhesim
- Emergjencat dentare, etj

Dhe sipas AMF, për periudhën janar-qershor 2024, kompania e sigurimit më e besuar edhe në këtë sigurim është SIGAL UNIQA, e cila zë 80% të tregut.

Besim konstant dhe i konsoliduar/ SIGAL UNIQA mbetet zgjedhja e parë për Sigurimin e Jetës, Shëndetit, Pronës dhe Automjetit



Grupi “SIGAL UNIQA” vazhdon të kryesojë tregun e sigurimeve në Shqipëri edhe për periudhën janar-korrik 2027.


Sipas raportit të publikuar nga AMF, ajo është lidere si në sigurimet e Jo-Jetës ashtu edhe në ato të Jetës si sa i përket primeve dhe dëmeve të paguara.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, sërish SIGAL UNIQA renditet e para.

PSE KY BESIM KONSTAT TEK SIGAL UNIQA?

- Kompania lider e sigurimeve në Shqipëri prej më shumë se 25 vjetësh
- Pjesë e “UNIQA Insurance Group”
- E shtrirë edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut përmes 8 kompanive të saj
- 1,5 milionë klientë, mbi 2400 punonjës dhe 1200 zyra në 3 shtete
- Bashkëpunon me kompanitë më të mëdha të risigurimit në botë çka bën që mos ti frikësohet asnjë dëmi, pavarësisht vlerës që mund të ketë
- Mbi 500 milionë euro dëme të paguara në 25 vjet.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve arrin në mbi 41 mijë/ “SIGAL UNIQA Invest”, më i madhi në vend sa i përket aseteve



Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare publikon të dhënat mbi tregun e pensioneve vullnetare në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2024.

Sipas AMF, gjatë kësaj periudhe, në tregun e pensioneve private ushtruan aktivitetin e tyre 6 fonde pensioni, ndërsa totali i aseteve neto arrin në 7,290.49 milionë lekë (72.68 milionë euro) dhe me një rritje prej 552 milionë lekë (8.20%) krahasuar me 6-mujorin e dytë 2023.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve gjatë 6-mujorit të parë të vitit arriti në 41,344 anëtarë.

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit, numri i anëtarëve të fondeve arrinte në 39,910 anëtarë.

Megjithëse në rritje, depërtimi i këtyre skemave ngelet ende në nivele modeste.

Numri i individëve që kontribuojnë për një pension privat është në afërsisht 3-4% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në vend, çka tregon një nivel ende shumë të ulët të mbulimit me fonde private të pensioneve.

Më i madhi për nga numri i anëtarëve rezulton “Credins Pension” ndërsa sa i përket numrit të aseteve neto, “SIGAL UNIQA INVEST” mbetet fondi më i madhi i pensioneve private në Shqipëri me 40,46% të totalit.

PSE “SIGAL UNIQA INVEST” mbetet zgjedhja e parë për një pleqëri të qetë financiarisht?

Ekspertiza: Me mbi 18 vjet përvojë në fushën financiare, “SIGAL UNIQA INVEST” ofron njohuri të thellë në këtë fushë duke ofruar zgjidhje për të përmbushur nevojat unike të kompanisë suaj dhe jo vetëm.

Përshtatja: “SIGAL UNIQA INVEST” bashkëpunon ngushtë me çdo klient për të projektuar një plan pensioni që përputhet me synimet e biznesit dhe preferencat e individëve.

Siguria: “SIGAL UNIQA INVEST” mundëson sigurinë dhe mbrojtjen e investimeve të punonjësve tuaj, duke investuar në instrumenta financiarë të besueshëm (Obligacione Shtetërore).


Emri i madh në treg: Duke qenë pjesë e ‘SIGAL UNIQA Group Austria’ dhe ‘UNIQA Insurance Group’, ky fond është një garanci më shumë për çdo individ apo biznes.

Bonuse për klientët

Me anëtarësimin në “SIGAL UNIQA INVEST” krahas kursimeve tuaja që rriten, keni mundësinë që vetëm me kartën e anëtarësisë të përfitoni nga bonuset fantastike që ju ndihmojnë të kenë akses në shërbime e produkte cilësore.

Raporti i BQK/ SIGAL UNIQA, lidere e sigurimeve edhe në Kosovë

Janar-Qershor 2024



Pak ditë pasi Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare në Shqipëri, përmes raportit për periudhën janar-qershor 2024, na tregoi se SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve në Shqipëri, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për SIGAL UNIQA në Kosovë.

Sipas raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), publikuar ditën e sotme, SIGAL UNIQA kryeson tregun e sigurimeve duke zënë mbi 15% të një tregu ku operojnë 10 kompani.

“Gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, kompania arriti të realizojë 15.36% të të gjitha primeve të shkruara në sektorin e Sigurimeve të Jo-Jetës. Kjo arritje thekson praninë dhe përkushtimin tonë për të ofruar shërbime të jashtëzakonshme për klientët tanë”, shkruan SIGAL UNIQA Kosovë në postimin e saj.

RAPORTI I PLOTË

<https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare-2/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifat-dhe-buletini-statistikor/>

Sigurimet e Jo-Jetës në Maqedoninë e Veriut arrijnë një rekord të ri/ Mbi 21 milionë euro prime vetëm në korrik

Nga sigurimet vullnetare, në krye mbetet Sigurimi i Pronës me 3 milionë Euro prime në një muaj. Më pas vjen KASKO me 2 milionë dhe Sigurimi Privat i Shëndetit me 1,7 milionë.

Korriku është një rekord për sa i përket shitjeve të policave të sigurimeve jo-jetë në Maqedoninë e Veriut, kryesisht për shkak se shitjet e sigurimit të detyrueshëm të makinave po rriten ndjeshëm, (85,000 automjete të rregjistruara në vetëm një muaj).

Sipas shifrave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), investimet e qytetarëve, kompanive dhe institucionet në sigurimet e jo-jetës në korrik arritën në 1,29 miliardë denarë (21,15 milionë euro). Ky është edhe niveli më i lartë mujor i investimeve në produktet e sigurimit në shtatë muajt e parë të vitit.

Deri më tani, muajt me primet më të larta, sipas të dhënave zyrtare, ishin janari dhe qershori me nga 1,22 miliardë denarë (19,8 milionë euro), çka tregon se kërkesa për sigurime në korrik është 13% më e lartë se janari dhe qershori.

Nga të gjitha klasat e sigurimit vullnetar, sigurimi i pronës mbetet në krye. Qytetarët, kompanitë dhe institucionet kanë lidhur mbi 14.000 kontrata në të cilat kanë investuar 184 milionë denarë (3 milionë euro).

Në vendin e dytë dhe të tretë sipas shitjes së sigurimeve vullnetare në korrik janë Sigurimi KASKO dhe Shëndeti Privat.



Në korrik, të siguarit kanë investuar 126,3 milionë denarë (2,05 milionë euro) për KASKO, me një rritje prej 9% krahasuar me qershorin e këtij viti.

Sa i përket Shëndetit Privat, kompanitë kanë arkëtuar 105,5 milionë denarë (1,7 milionë euro).

Vlen të theksohet se në kulmin e sezonit të pushimeve verore, shitja e sigurimit “Shëndet në Udhëtim” arriti në 44,8 milionë denarë (728.000 euro) ose 16% më shumë krahasuar me muajin e kaluar.

Në klasën më të madhe të sigurimeve, rritjen më të madhe të shitjeve e ka sigurimi TPL.

Gjatë korrikut, kompanitë arkëtuan 693,4 milionë denarë (11,3 milionë euro) nga sigurimet e detyrueshme të automjeteve (TPL, Karton Jeshil, Kufitare)

Krahasuar me korrik 2023, shitjet janë rritur për mbi 60 milionë denarë (1 milionë euro).

Sa i përket dëmeve të paguara gjatë muajit korrik ato arrijnë në 470 milionë denarë (7.7 milionë euro)

‘Dëmet e shkaktuara nga moti ekstrem po rriten’/ Çfarë propozon CEO i “UNIQA Insurance Group”

“UNIQA Insurance Group” publikoi ditën e sotme raportin për 6-mujorin e parë të vitit 2024.

Fitimet para taksave u rritën me 19% duke arritur në 277.5 milionë euro.

Primet e shkruara gjithashtu u rritën, duke arritur në rreth 4.1 miliardë euro ose 8,8% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Në rritje kontribuan veçanërisht sigurimi i pronës (+ 10.7%) dhe sigurimi shëndetësor (+ 10.2%).

Rritja e ekspozimit ndaj motit ekstrem Ngjarjet ekstreme të motit, të lidhura me ndryshimet klimatike, po ndikojnë gjithashtu edhe tek kompanitë e sigurimeve.

“Në vitet dhe dekadat e fundit, sasia e dëmeve nga moti që ne u paguajmë klientëve tanë është rritur ndjeshëm“, shprehet CEO i “UNIQA”, Andreas Brandstetter të enjten.

Sipas tij, ngjarje të tilla “jo vetëm që nuk po ulen, por përkundrazi po rrisin barrën e tyre“.

Në gjysmën e parë të vitit, sipas tij, UNIQA pagoi rreth 74 milionë euro dëmshpërblime që lidhen me fatkeqësitë natyrore. Shifër pak më e ulët në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, “por viti 2024 nuk ka përfunduar ende”, thekson Brandstetter. Ndër të tjera, ai iu referua stuhive të fundjavës së shkuar dhe dëmeve që ajo la, të cilat ende nuk janë reflektuar në shifrat e kompanisë.



Austria, veçanërisht e prekur nga përmbytjet Austria është veçanërisht e prekur nga ngrohja globale dhe pasojat e saj, si përmbytjet, për shkak të vendndodhjes së saj si një vend pa dalje në det dhe topografisë së saj, vuri në dukje Brandstetter.

Prandaj, CEO i “UNIQA” mbështet integrimin e mbulimit të fatkeqësive natyrore në sigurimin ekzistues nga zjarri. Një model i tillë do të kërkonte kontribute nga njerëzit që nuk jetojnë në zona veçanërisht të prekura nga fatkeqësitë natyrore.

Për të prekurit, sipas tij, kjo mund të garantojë një të drejtë ligjore për kompensim “për 100% të vlerës të objekteve të siguruara.

Duke patur parasysh ndryshimet gjithnjë e më të dukshme klimatike, Brandstetter kundërshton logjikën se përse politikanët po mbyllin sytë dhe veshët për një kohë të gjatë. Siç vuri në dukje ai, “UNIQA Insurance Group” dëshiron të japë një kontribut në parandalimin e dëmeve të shkaktuara nga kriza klimatike. Për këtë arsye, ajo themeloi së fundmi kompaninë e saj konsulente me qëllim përgatitjen e kompanive për krizën klimatike dhe minimizimin e rreziqeve përkatëse, “UNIQA Sustainable Business Solutions”.



**A commUNItY is
a group of people
who agree to grow
together.**

Ndërto rrjetin. Sill ndryshim. Bashkohu me komunitetet

Gjatë viteve të fundit, ne kemi arritur transformime të jashtëzakonshme së bashku. Sekret i suksesit tonë ka qenë përqendrimi ynë te klientët tanë – një parim që udhëheq gjithçka që bëjmë në UNIQA. Kemi zbatuar këtë qasje të përqendruar te klientët në modelet tona të biznesit Retail, Corporate & Affinity dhe Bancassurance. Me një themel të fortë, jemi të gatshëm të zgjerojmë biznesin tonë edhe më tej, gjithmonë duke e mbajtur klientin në qendër të veprimeve tona.

Për të përmirësuar bashkëpunimin tonë dhe metodat fleksibël të punës, po fokusohemi në Inicativat Strategjike Kryesore (KSIs) përmes modelit tonë unik të bashkëpunimit ndër-funksional dhe ndër-kombëtar, komunitetet (commUNIties).

Kjo qasje mbështet theksin tonë të fortë në zhvillimin e njerëzve që është çelësi kryesor i suksesit tonë.

Çfarë janë commUNIties?

commUNIties janë një platformë e mirëvendosur për punonjësit që të sjellin talentet, idetë dhe aftësitë e tyre së bashku dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Ky mënyrë e re e bashkëpunimit fleksibël ndërtohet mbi praktikatat e vendosura dhe është projektuar për të nxitur bashkëpunimin ndër-kombëtar dhe ndër-funksional.

commUNIties, e themeluar në vitin 2021, tani po evoluon në një nivel të ri. Aktualisht, kemi 12 commUNIties me mbi 500 anëtarë dhe jemi të gatshëm të zgjerojmë këtë model bashkëpunimi fleksibël në të gjithë organizatën.

Pse të bashkoheni me commUNITies?

commUNITies janë të hapura dhe të gatshme për të rekrutuar anëtarë të rinj. Aktivitetet e commUNITy ofrojnë përvojë praktike, ekspozim ndaj ideve dhe teknologjive të reja, si dhe mundësi për të punuar në një mjedis ndërkombëtar.

Ky angazhim ndihmon anëtarët të zhvillojnë aftësi të reja, të zgjerojnë ekspertizën e tyre dhe të avancojnë në karrierë. Si anëtar i një commUNITy, do të ndërtoni një rrjet ndërkombëtar dhe do të përshiheni më thellë në organizatën tonë. Gjithashtu, do të jeni drejtpërdrejt të ekspozuar ndaj menaxhmentit të lartë dhe do të përfitoni nga shpërblimet jo-financiare si eventet e commUNITy dhe mundësitë për zhvillim të karrierës.

Nëse ju pëlqen të punoni në një mjedis ndërkombëtar, dëshironi të praktikoni aftësitë tuaja në anglisht dhe jeni të etur të ndani njohuritë dhe përvojën tuaj me kolegët, commUNITies janë vendi i duhur për ju.

Bashkohuni me ne për të qenë më afër vendimeve strategjike dhe për t'u vlerësuar për kontributin tuaj.

Çfarë do të bëni në commUNITies?

Ju do të punoni në ekipe fleksibël dhe do të mbështesni zbatimin e iniciativave strategjike kryesore (KSIs), të përcaktuara në cikle strategjike prej 6 muajsh. KSIs duhet të plotësojnë disa kërkesa, siç është ndryshimi strategjik i një statusi ekzistues, krijimi i një ndikimi pozitiv për shumë njësi biznesi me një shkallë të lehtë për Grupin dhe të jenë transparentë me objektiva të qarta të përcaktuara.

Ju gjithashtu do të përfitoni nga përmirësimi i vazhdueshëm ndër-kombëtar dhe ndarja e njohurive.

Përfshihuni

Vizitoni hapësirën tonë të dedikuar në SharePoint për të mësuar më shumë rreth KSIs dhe commUNITies. Shfaqni motivimin tuaj dhe kordinohuni me menaxherin tuaj. Kontaktoni me organizatorin e commUNITy që ju intereson për një kontakt të parë.

Bashkohuni me commUNITies sot dhe bëhuni pjesë e të ardhmes emocionuese të UNIQA-së!



commUNITies
Our new agile
collaboration model

**Join
now!**

jetojmë më mirë së bashku

Mbroni atë që mund
të mbroni vetë

Sigurimi
i Shtëpisë
te SIGAL
UNIQA



COPYRIGHT SIGAL UNQA 2024

Përmbajtja e këtij newsletter dhe të gjitha të drejtat e saj i përkasin kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA Group Austria dhe përdorimi nga të tretë, pa autorizimin e SIGAL UNIQA nuk është e lejuar. Shpërndarja e këtij newsletter mund të bëhet vetëm nëpërmjet kanaleve zyrtare të kompanisë.